

VENDIM
Nr. 108, datë 1.10.2013

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
SHOQËRISË “JUANA” SHPK NGA HEC “ORENJE” ME NR. 14, SERIA PV04P, LËSHUAR
ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 5,
DATE 12.3.2004

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Juana” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 14, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 12.3.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Juana” sh.p.k. plotëson kërkesat e rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Juana” sh.p.k. me nr. 14, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Orenje” me fuqi 75 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 12.3.2004.

2. Fuqia e instaluar e hec “Orenje”, nga 75 KW të bëhet 875 KW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo